



## VENDIM MBI KËRKESËN PËR RISHQYRTIM

**Data e miratimit: 10 nëntor 2014**

**Numri i lëndës: 2014-04**

**Tomë Krasniqi**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 10 nëntor 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa ishte regjistruar më 3 shkurt 2014.
2. Më 27 maj 2014, Paneli ka gjetur ankesën të papranueshme. Është vënë re se ankuesi kundërshton vendimet e gjykatave të Kosovës, si dhe pikëpamjen e gjykatasit të EULEX-it se lënda e ankuesit nuk hynte në kuadër të juridikzionit të EULEX-it.

3. Në lidhje me të parën, Paneli ka vërejtur se nuk ishte treguar apo edhe argumentuar se gjykatësit e EULEX-it kanë qenë të përfshirë në ndonjë cilësi në marrjen e këtyre vendimeve (shih *Mustafa kundër EULEX-it*, 2011-03, 8 prill 2011 në par. 22).
4. Në lidhje me të fundit, Paneli ka gjetur se nuk kishte asnjë tregues se gjykatësi i EULEX-it i kishte shkelur të drejtat e njeriut të ankuesit, kur iu ishte përgjigjur ankesës së tij.
5. Kështu, Paneli ka konstatuar se nuk kishte kompetencë për të shqyrta ankesën, pasi ajo ka hyrë jashtë juridiksonit të tij në kuptimin e rregullit 29 (d) të rregullores së vet të punës.
6. Më 9 qershor 2014, ankuesi ka kërkuar të bëhej rishqyrtimi i ankesës së tij në kuptimin e rregullit 42 të rregullores së punës së Panelit.
7. Më 17 qershor 2014, ankuesi i ka ofruar Panelit të dhëna të tjera.

#### **Kërkesë për rishqyrtim**

8. Ankuesi ka kërkuar nga Paneli të bëhej rishqyrtimi i vendimit të tij të datës 27 maj 2014, duke e paraqitur aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 12 shkurt 2014, i cili e refuzon kërkesën e tij për rishikim të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të datës 7 tetor 2013.
9. Ankuesi pohon se Paneli ka juridikson mbi lëndën e tij, posaçërisht pasi që “*është vendosur prej autoritetet e kompetente që shkeljet e të drejtës së individit apo të një grupi individësh, pa marrë parasysh se nga kush janë shkelur këto të drejta, të vlerësohen ekskluzivisht nga ndonjë autoritet publik apo shtetëror që ka shkaktuar këto shkelje,*”.
10. Paneli thekson se procedura për rishqyrtim e parashikuar në rregullën 42 ka për qëllim të ofrojë një mekanizëm procedural, përmes së cilës parashtruesi i ankesës mund të kërkoj rishqyrtimin e një vendimi të papranueshmërisë vetëm kur një fakti të ri, të cilin ai ose ajo nuk ka mundur ta dijë në kohën e ankesës filloreste do të kishte një ndikim vendimtar mbi gjetjet e Panelit (shih *Y kundër EULEX-it* (rishqyrtim, nr. 2011-28, paragrafët. 7-8).
11. Në këtë rast, ankuesi nuk ka paraqitur dëshmi për një fakt të ri siç është përcaktuar më lartë.
12. Në bazë të rregullës 25, parografi 1, i rregullores së punës, bazuar në konceptin e llogaridhënieve në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli thekson se në parim nuk është kompetent për të shqyrta procedural gjyqësore të gjykatave të Kosovës. Për më tepër, Paneli tashmë ka konstatuar se edhe nëse gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të ndonjë gjykate të caktuar, nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih ndër të tjera *Maxhuni kundër EULEX-it*, nr. 2013-24, par. 12; 7 prill 2014, par.

*Halili kundër EULEX-it, nr. 2012-08, 15 janar 2013, par. 21; Pajaziti kundër EULEX-it, nr. 2012-05, 4 tetor 2012 par. 9-10; Dobruna kundër EULEX-it, nr. 2012-03, 4 tetor 2012, par. 12).*

13. Nga pjesa më lartë del se ankuesi në këtë rast nuk ka arritur të vërtetojnë se janë plotësuar kushtet për rishqyrtim të vendimit të papranueshmërisë të Panelit të datës 27 maj 2014.

### **PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI**

*Refuzon kërkesën e ankuesit për rishqyrtim.*

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese